

THIRRJA PËR APLIKIM 2022

# Programi i Trajnimit në Kërkimin Shkencor

Përmirëso aftësitë kërkimore  
me ndihmën e profesionistëve!

Afati për aplikimin  
**12 Shtator 2022**

Përzgjedhja  
**19 Shtator 2022**

Dorëzoni aplikimin në shqip  
ose në anglisht në:

**info@samifrasheri.org**

Subjekti duhet të jetë

Programi i Trajnimit në  
Kërkimin Shkencor

**Aplikimi – Emri juaj**



Organizohet nga



Qëllimet kryesore të programit të trajnimit në kërkimin shkencor janë të përmirësojë aftësitë kërkimore të studiuesve të rinj dhe të kontribuojë në zhvillimin e një kulture të shëndetshme kërkimore shkencore në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi dhe Maqedoninë e Veriut. Në vitin 2022, programi do të mbështesë kërkimin mbi temat e mëposhtme:

- a. Skena fetare e Shqipërisë që prej viteve 1990
- b. Marrëdhëniet ndërfetare në Shqipëri pas viteve 1990
- c. Feja dhe shteti në Shqipërinë postkomuniste
- d. Diskursi mbi lirinë e fesë dhe shekullarizmin në median shqiptare
- e. Roli i Islamit në shoqërinë kosovare (periudha jugosllave, vitet 1990 dhe periudha pas pavarësisë)
- f. Bashkëpunimi rajonal dhe stabiliteti e prosperiteti i Ballkanit
- g. Bashkëpunimi rajonal në Ballkan: Ndërmjet qasjeve të paritetit dhe atyre hegjemoniste
- h. Lufta në Ukrainë dhe pasojat e saj për Ballkanin
- i. Dhuna politike dhe mbi-sigurizimi i radikalizmit
- j. Edukimi gjatë pandemisë COVID19: Perspektiva e studentëve

## Procedura e aplikimit

Kërkesat për aplikimin janë:

- Formulari aplikimi i plotësuar
- Një propozim paraprak kërkimor (fusha e gjerë e kërkimit, tema, rëndësia e saj, qëllimet, pyetjet/hipotezat, metodat e kërkimit, rezultatet e pritura: maksimumi 2000 fjalë)
- Një CV profesionale

## Kush mund të aplikojë

Që të konsiderohen, pjesëmarrësit e mundshëm duhet të kenë përfunduar së paku studimet universitare të Ciklit të Dytë (Master) dhe preferencë do t'i jepet stafit të ri në universitete ose në institute kërkimore dhe anëtarëve të OJQ-ve me orientim kërkimor nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia e Veriut. Kërkohe komandë e shkëlqyer e gjuhës angleze, e folur dhe e shkruar.

## Afati i fundit

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda datës 20 shtator 2022 në gjuhën shqipe ose angleze me e-mail në adresën e mëposhtme: **info@samifrasheri.org**. Titulli i e-mailit duhet të jetë: Aplikimi për Programin e Trajnimit në Kërkimin Shkencor - **emri juaj**.

## Përzgjedhja

Komisioni përzgjedhës do të zgjedhë 10-15 pjesëmarrës mbështetur në formimin profesional dhe propozimet paraprake kërkimore. Të gjithë aplikantët do të njoftohen për statusin e tyre deri më 24 shtator 2022.

## Përshkrimi i programit

Në fazën paraprake të programit, pjesëmarrësve do t'u sigurohet mbështetje në zhvillimin e projekt-propozimeve kërkimore konkurruese.

Në datat 2-3 tetor 2022 do të zhvillohet një seminar fillestar mbi kërkimin akademik në Tiranë. Pjesëmarrja në seminar është e detyrueshme. Mospjesëmarrja për çfarëdo arsye do të pasohet me përjashtimin e pjesëmarrësit.

Pas seminarit, pjesëmarrësit do të kenë kohë deri më 18 tetor për të dorëzuar projekt propozimet kërkimore në anglisht. Trajnerët do të japin komente deri më 25 tetor. Më pas, pjesëmarrësit do të dorëzojnë propozimet e tyre përfundimtare kërkimore në shqip ose anglisht jo më vonë se 8 nëntori.

Dhjetë nga aplikantët do të përzgjidhen për pjesëmarrje të mëtejshme bazuar në meritat e propozimeve të tyre kërkimore. Aplikantët do të njoftohen për përzgjedhjen përfundimtare deri më 15 nëntor. Aplikantët e suksesshëm do të marrin secili një grant neto prej 600 euro, që do të disbursohet në dy këste. Çdo taksë do të mbulohet nga organizatorët.

Anëtarët pritet të kryejnë kërkime cilësore sipas protokollit të kërkimit të rënë dakord gjatë procesit të aplikimit. Si produkt përfundimtar, secili bashkëpunëtor do të paraqesë një studim që organizatorët mund të vendosin ta publikojnë në një nga revistat periodike ose publikimet e organizatorëve, subjekt i rishikimit të dyfishtë (double blind review).

Pjesëmarrësit do të kryejnë detyrat specifike të mëposhtme:

- të kryejnë kërkimin mbi propozimin e miratuar kërkimor,
- të marrin pjesë në seminarin e trajnimit për kërkimin dhe shkrimin më 20-21 nëntor 2022,
- të dorëzojnë një draft të parë të kërkimit në shqip deri më 01 Shkurt 2023 (rreth 8000 fjalë),
- të dorëzojnë një draft të dytë në shqip deri më 20 Shkurt 2023,
- të dorëzojnë tekstin përfundimtar deri më 15 mars 2023 dhe
- të punojnë për përgatitjen e studimit për botim, nëse organizatorët vendosin të ndjekin atë rrugë.

# Programi i Trajnimit në Kërkimin Shkencor

THIRRJA PËR APLIKIM 2022

Të gjitha punimet kërkimore të miratuara do të publikohen në faqen e internetit të organizatorëve. Përfundimi me sukses i programit kërkon që pjesëmarrësi:

- të ndjekë plotësisht dhe të marr pjesë aktive në të gjitha seksionet e programit, dhe
- të kryej të gjitha detyrat në kohë.

Programi do t'u sigurojë pjesëmarrësve, studiues me përvojë si mentorë, të cilët do t'i këshillojnë dhe mbikëqyrin ata gjatë fazës së zbatimit të projekteve kërkimore.

Posaçërisht, mentorët do të:

- a. ofrojnë udhëzime metodologjike dhe
- b. rishikojnë dhe vlerësojnë punimet në faza të ndryshme.

## Mentorët

**Dr. Mentor Beqa** është pedagog i Politikës Ndërkombëtare dhe Metodave të Kërkimit në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Politike në Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës dhe Drejtor Ekzekutiv i Institutit të Studimeve Politike "Sami Frashëri". Ai u diplomua për Gazetari në Universitetin e Tiranës, më pas ndoqi studimet Master për Sigurinë Ndërkombëtare në Universitetin e Gjenevës dhe mori titullin Doktor i Shkencave Politike në Marrëdhënie Ndërkombëtare nga Universiteti Europian i Tiranës. Fushat e tij të ekspertizës përfshijnë politikën strategjike, politikën e sigurisë, teorinë politike me fokus në teorinë politike ndërkombëtare dhe metodat e kërkimit shkencor. Është autor i disa publikimeve në revista shkencore. Ai gjithashtu ka kontribuar me raporte të ndryshme të politikave publike në kuadër të projekteve kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare. Dr. Beqa ka mbajtur poste publike si ajo e Këshilltarit dhe Shefit të Kabinetit të Ministrit të Mbrojtjes së Shqipërisë gjatë viteve 2009–2013 dhe Këshilltar i Ministrit të Brendshëm në vitin 2017.

**Jeton Mehmeti (PhD)** është anëtar i fakultetit në RIT (Rochester Institute of Technology) Kosovë. Para se t'i bashkohej RITK-ut, ai kaloi pesë vjet si asistent mësimdhënës në Universitetin e Prishtinës «Hasan Prishtina», dy vjet si instruktor i TLP në Institutin A.U.K., dhe një vit si pedagog në kolegjin UBT. Përveç kësaj, ai ka qenë pedagog i ftuar në Universitetin e Illinois dhe në Universitetin e Grazit. Jetoni është autor i disa punimeve akademike të botuara nga Brill, Palgrave Macmillan, Nomos, Peter Lang, Brown Walker Press dhe të tjerë. Punimet e tij akademike i ka prezantuar në konferenca të ndryshme ndërkombëtare në SHBA, Gjermani, Itali, Belgjikë, Austri, Hungari, Turqi e Malajzi. Ai është përfitues i shumë bursave të shquara, duke përfshirë Marshall Memorial Fellowship (SHBA), bursë kërkimore OeAD (Austri) dhe bursë për Akademinë e Liderit për Zhvillim (Universiteti Stanford). Atij gjithashtu iu dha Bursa Ballkanike për Ekselencë Gazetarie për hulumtimin e tij mbi papunësinë e të diplomuarve në Kosovë dhe Shqipëri. Jetoni është kandidat për doktoraturë në Universitetin e Grazit, Austri. Ai ka një diplomë master në politikën publike (CEU) dhe dy diploma BA, një në komunikim dhe një në fenë krahasuese (IIUM).

## Afatet kohore

|   |            |   |
|---|------------|---|
| 1 | 22 KORRIK  | <b>Njoftimi i programit</b>                           |
| 2 | 12 SHTATOR | <b>Afati i dorëzimit të aplikimit</b>                 |
| 3 | 19 SHTATOR | <b>Përzgjedhja paraprake (shortlist)</b>              |
| 4 | 1-2 TETOR  | <b>Seminari për shkrimin e propozimeve kërkimore</b>  |
| 5 | 18 TETOR   | <b>Dorëzimi i propozimit të projektit kërkimor</b>    |
| 6 | 25 TETOR   | <b>Shqyrtimi i propozimit të kërkimit</b>             |
| 7 | 8 NËNTOR   | <b>Dorëzimi i propozimit të kërkimit të rishikuar</b> |